



Bazuar në nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, neni 25, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenin 65, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 77/16 gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10 / 03 prill 2017), nenin 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, paragrafi 2, nënparagrafi 2.3, të Ligjit Nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.12/03 maj 2013), dhe nenin 136 të Ligjit Nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10 / 14 maj 2026), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 maj 2026 miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR RAPORTIMIN E STATISTIKAVE TË INSTRUMENTEVE TË PAGESAVE**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Kjo rregullore përcakton rregullat për raportimin e statistikave mbi instrumentet dhe shërbimet e pagesave në Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, duke përfshirë llojet e statistikave që raportohen, subjektet raportuese, detyrimet e tyre, periudhat dhe mënyrat e raportimit, si dhe parimet e konfidencialitetit dhe cilësisë së të dhënave. Qëllimi është të sigurohet mbledhja, përpunimi dhe publikimi i të dhënave të sakta dhe të krahasueshme për të rritur transparencën, për të mbështetur analizat dhe vendimmarrjen e BQK-së, si dhe për të përmirësuar efikasitetin e sektorit të pagesave në Republikën e Kosovës.
2. Kjo rregullore zbatohet për të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe operatorët e sistemit të pagesave në Republikën e Kosovës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

1. Të gjitha termat e përfshira në këtë rregullore, kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuara në Ligjin për Sistemin e Pagesave, Ligjin për Shërbimet e Pagesave dhe/ose të përcaktuara më poshtë, për qëllime të kësaj rregullore:
  - 1.1. **BQK** – Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;
  - 1.2. **Ofrues i shërbimit të pagesave - OSHP** – nënkupton çdo person fizik ose juridik të licencuar, regjistruar ose autorizuar sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi për të ofruar shërbim pagese;

- 1.3. **Sistem i pagesave** - nënkupton një sistem ku dy ose më tepër pjesëmarrës bashkëpunojnë në mundësimin e kryerjes së pagesave apo lehtësimin e qarkullimit të parasë, dhe përfshin çdo marrëveshje dhe/apo procedurë për procesimin, shkëmbimin, kliringun, strukturimin dhe/apo shlyerjen e transaksioneve të pagesave. Ky term përfshin këmbimet në instrumentet e pagesave;
- 1.4. **Shërbime Pagesash** - do të thotë një nga aktivitetet e mëposhtme të biznesit:
- 1.4.1. Shërbime që mundësojnë vendosjen e parave të gatshme në një llogari pagese, si dhe të gjitha operacionet e nevojshme për operimin e një llogarie pagese;
  - 1.4.2. Shërbime që mundësojnë tërheqjen e parave të gatshme nga një llogari pagese, si dhe të gjitha operacionet e nevojshme për operimin e një llogarie pagese;
  - 1.4.3. Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, duke përfshirë transferimet e fondeve në një llogari pagese me ofruesin e shërbimit të pagesave të përdoruesit ose me një ofrues tjetër të shërbimit të pagesave.
  - 1.4.4. Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave ku fondet mbulohen nga një linjë krediti për një përdorues të shërbimit të pagesave.
  - 1.4.5. Lëshimi i instrumenteve të pagesës dhe/ose marrja e transaksioneve të pagesave;
  - 1.4.6. Dërgesa parash;
  - 1.4.7. Shërbime inicimi pagesash;
  - 1.4.8. Shërbime informacioni për llogarinë.
- 1.5. **Operator i sistemit të pagesave** – nënkupton Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, si entiteti që është përgjegjës për operimin dhe/apo administrimin e një sistemi të pagesave, kliringut apo shlyerjes së letrave më vlerë / apo një operator tjetër i licencuar dhe mbikëqyrur nga BQK;
- 1.6. **Raportues** – nënkupton operatorët e sistemit të pagesave dhe ofruesit e shërbimeve të pagesave.

### **Neni 3 Raportuesit**

1. Raportuesit që i nënshtrohen kësaj Rregullore janë ofruesit e specifikuar të shërbimeve të pagesave (në vijim: OSHP) dhe operatorët e sistemit të pagesave.
2. Për qëllime të kësaj rregulloreje, ofruesit e shërbimeve të pagesave janë:
  - 2.1. Bankat siç përkufizohen në Ligjin për Bankat;
  - 2.2. Institucionet e parave elektronike, përfshirë degët e institucioneve të huaja të parave elektronike, kur dega është e vendosur në Kosovë dhe zyra qendrore ndodhet në një juridiksion të huaj, për aq sa shërbimet e pagesave të ofruara nga dega në Kosovë lidhen me emetimin e parasë elektronike;
  - 2.3. Institucionet e pagesës, përfshirë degët e institucioneve të huaja të pagesave, ku dega e tillë gjendet në Kosovë dhe zyra qendrore e atij institucioni gjendet në një juridiksion të huaj;

- 2.4. Institucionet Postare të cilat janë të autorizuar me ligjet e Kosovës që të ofrojnë shërbime të pagesave;
  - 2.5. BQK, kur nuk vepron në cilësinë e saj si autoritet monetar apo autoritet publik;
  - 2.6. Autoritetet publike qendrore dhe komunale kur nuk veprojnë në cilësinë e tyre si autoritete publike.
3. Operator i sistemit të pagesave mund të jenë institucionet e parapara në nenin 4, paragrafi 2 i Rregullores për Licencimin, Rregullimin dhe Mbikëqyrjen e Operatorëve të Sistemeve të Pagesave.

#### **Neni 4**

##### **Obligimet për raportim**

1. Në pajtim me nenin 25, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, raportuesit i nënshtrohen kërkesave të raportimit në BQK.
2. Në raste të caktuara, BQK mund të kërkojë nga raportuesit paraqitjen e raporteve statistikore shtesë, të bazuar në mostër apo formularë të përcaktuara paraprakisht. BQK i njofton raportuesit me shkrim dhe, kur është e nevojshme, i kontakton për të dhënë udhëzime lidhur me mënyrën, afatet dhe procedurat e raportimit.
3. Raportuesit janë të obliguar që t'i ofrojnë informatat statistikore që i kërkon BQK me qëllim të përpilimit të Statistikave të Instrumenteve të Pagesave në nivel të Republikës së Kosovës.
4. Informatat e kërkuara statistikore duhet të dorëzohen në përputhje me formatet, tabelat, afatet dhe kërkesat teknike të përcaktuara nga BQK.
5. Raportuesit janë të obliguar të sigurojnë që të dhënat statistikore të raportuara të jenë të sakta, të plota dhe të verifikuara para se të dorëzohen në BQK.
6. Raportuesit janë të obliguar të bashkëpunojnë me BQK-në gjatë procesit të verifikimit, validimit dhe sqarimit të të dhënave statistikore të raportuara.
7. Raportuesit që nuk i respektojnë kërkesat statistikore të përcaktuara me këtë rregullore, do t'i nënshtrohen masave përkatëse, të cilat ndërmerren në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 5**

##### **Përmbajtja e të dhënave**

1. Raportuesit janë të detyruar që BQK-së t'i dorëzojnë të dhënat të cilat përfshijnë:
  - 1.1. Të dhënat mbi llogaritë;
  - 1.2. Kartelat e lëshuara në vend;
  - 1.3. Pajisjet që mundësojnë inicimin e pagesave – Terminalet
  - 1.4. Transaksionet e pagesave sipas instrumenteve dhe llojeve;
  - 1.5. Transaksionet e pagesave sipas tipit të terminaleve;
  - 1.6. Terminalet sipas komunave;

1.7. Vlera aktive e parasë elektronike;

1.8. Raporti për tentimet/keqpërdorimet përmes instrumenteve të pagesave

2. Të dhënat nga paragrafi 1 i këtij neni raportohen në përputhje me kërkesat e specifikuara dhe formatin e përcaktuar nga BQK me udhëzimin për raportimin e statistikave të instrumenteve të pagesave.
3. BQK sipas nevojës me qëllim të harmonizimit me zhvillimet e shërbimeve të reja të pagesave, mund të plotësojë Udhëzimin për Raportimin e Statistikave të Instrumenteve të Pagesave me tabela shtese ose ndryshimin / plotësimin e tabelave ekzistuese.

## **Neni 6**

### **Raportet dhe afatet e raportimit**

1. Raportet statistikore mbi instrumentet e pagesave duhet të dorëzohen në BQK brenda afatit prej 15 ditësh kalendarike pas përfundimit të periudhës referuese për të cilën raportohen të dhënat.
2. Kur afati i raportimit i përcaktuar me këtë rregullore përkon me ditë jo-pune zyrtare në Republikën e Kosovës, raportimi kryhet në ditën e parë pasuese të punës, e cila konsiderohet si datë zyrtare e raportimit.

## **Neni 7**

### **Publikimi dhe rishikimi i të dhënave**

1. BQK publikon statistikën për instrumentet e pagesave si të dhëna të hapura mbi bazën e të dhënave të raportuara nga subjektet raportuese. Këto të dhëna publikohen në formë të agreguar në faqen zyrtare të BQK-së, në baza mujore, tremujore dhe vjetore.
2. Të dhënat e publikuara konsiderohen zyrtare në momentin e publikimit; megjithatë, ato mund të rishikohen nëse pas publikimit konstatohet se përmbajnë lëshime, pasaktësi ose gabime në të dhënat e raportuara.
3. Rishikimi i të dhënave mund të kryhet si rezultat i:
  - 3.1. korrigjimeve ose përditësimeve të të dhënave nga raportuesit;
  - 3.2. përmirësimeve në udhëzimin për raportim;
  - 3.3. ndryshimeve në standardet statistikore ndërkombëtare;
  - 3.4. identifikimit të gabimeve gjatë proceseve të kontrollit të cilësisë së të dhënave.
4. Në rast të identifikimit të gabimeve ose mospërputhjeve, BQK rishikon raportet përkatëse dhe sipas nevojës, kërkon nga raportuesit dorëzimin e të dhënave të korrigjuara brenda afateve të përcaktuara nga BQK.
5. Çdo rishikim i të dhënave, i nënshtrohet një procesi miratimi, varësisht nga lloji dhe ndikimi i rishikimit, në pajtim me Politikën për rishikimin e statistikave në BQK.
6. BQK siguron transparencë të plotë duke informuar përdoruesit për natyrën e rishikimit të të dhënave.

## **Neni 8**

### **Konfidencialiteti**

Në pajtim me legjislacionin në fuqi, BQK garanton konfidencialitetin e të dhënave të cilat dërgohen nga subjekti raportues dhe i përdorë ato vetëm për qëllime statistikore, siç është përcaktuar në këtë rregullore.

## **Neni 9**

### **Verifikimi dhe mbledhja e detyruar e të dhënave**

BQK verifikon të dhënat e raportuara, përmes inspektimeve në teren, si dhe kur është e nevojshme për mbledhjen e detyrueshme të çdo informacioni që raportuesit janë të obliguar ta sigurojnë sipas kësaj rregulloreje. Në veçanti, këto verifikime zbatohen në rastet kur një institucion raportues nuk i përmbush standardet minimale të raportimit, përfshirë dërgimin e të dhënave, saktësinë e tyre dhe pajtueshmërinë me konceptet e përcaktuara në Udhëzimin për Raportimin e Statistikave të Instrumenteve të Pagesave.

## **Neni 10**

### **Kualiteti i informatave të raportuara**

1. Me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së statistikave të raportuara, BQK monitoron dhe vlerëson të dhënat e dorëzuara nga raportuesit, duke ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme dhe të nevojshme për të siguruar që cilësia e tyre të jetë në përputhje me standardet statistikore të përcaktuara.
2. Në kuadër të këtij procesi, BQK mund të kërkojë nga raportuesit sqarime shtesë, korrigjime ose plotësime të të dhënave, si dhe të ofrojë udhëzime për përmirësimin e proceseve të raportimit dhe forcimin e kontrollit të brendshëm mbi cilësinë e të dhënave.

## **Neni 11**

### **Dispozitat Përfundimtare**

Me qëllim të sigurimit të zbatimit efektiv të kërkesave teknike të kësaj Rregulloreje, BQK do të nxjerrë Udhëzimin për Raportimin e Statistikave të Instrumenteve të Pagesave, i cili do të përcakton në mënyrë të detajuar procedurat e raportimit, përmbajtjen dhe strukturën e të dhënave që duhet të raportohen, afatet e raportimit, si dhe formatin teknik të dorëzimit, brenda të cilave subjektet raportuese janë të obliguara të paraqesin informacionin e kërkuar.

## **Neni 12**

### **Zbatimi, masat përmirësuese dhe ndëshkime**

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj Rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe/apo ndëshkimeve administrative civile, në përputhje me Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Ligjin nr. 04/L-155 për Sistemet e Pagesave dhe Ligjin nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave.

**Neni 13**  
**Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja mbi Statistikat e Instrumenteve të Pagesave, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, më datë 28 shkurt 2023.

**Neni 14**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit të saj nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Dr.sc. Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës